ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **QENDRA E STUDENTEVE**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr1 i prokurimit	**1020890500-22-12575-2-1-1**
Nr i brendshëm	**QS 2022 031 211**

Sa i përket tenderit për **Mirëmbajtja higjenike e objekteve të Qendres së Studentëve**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

"DEZINFEKTIMI AD"SHPK

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

PRISHTIN

(Adresa)

PRRISHTIN *10 000*

(Vendi) *(Kodi postar)*

049

(Numri Telefonit) *(Numri i Faks-it)*

ARBANA MUNISHI

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

addezinfektimi@gmail.com

[1] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

(Adresa elektronike)

13.01.2023

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Njoftimi për kontratë: 09.11.2022 Hapja e paraparë: 19.12.2022 Kërkesë për ri shqyrtim: 12.12.2022 *VENDIMI AK:15.12.2022* *02.01.2023 Kerkes per rishqyrtim* *04.01.2023 vedimi i AK-së*

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ Jo ☐

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ *Jo* ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☐ V Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 6 (Ekonomiciteti dhe Efikasiteti) – LPP
Neni 7 (Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi) – LPP
Neni 69 (Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale) - LPP
Neni 26.8 (Kriteret e përzgjedhjes) - RRUOPP

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Autoriteti Kontraktues me datën 09.11.2022 ka publikuar njoftimin mbi korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara, duke shtuar disa kërkesa në dosjen e tenderit, e që ne mendojmë se të njejtat nuk janë kërkesa në përputhje me dispozitat e LPP-së, dhe janë në kundërshtim me Qëllimin e kontratës sipas nenit 1 të LPP-së, dhe nenit 7 të LPP-së, pasi që të njejtat pos që janë të tepërta janë edhe diskriminuese dhe i jep kuptim se si Autoritet Kontraktues favorizoni ndonjë operator të caktuar ekonomik.

Autoriteti Kontraktues është dashur që të ketë në konsideratë Nenin 6 paragrafin1 të LPP-së pasi që në parim ceket mjaftë kjartë se "Të gjitha autoritetet kontraktuese,
janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën sa më ekonomike, njëkohësisht duke marr në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit".

Autoriteti Kontraktues poashtu nuk ka pasur parasysh as dispozitat tjera ligjore si Nenin 7 paragrafin 1 ku thuhet "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente" dhe paragrafin 2 ku ceket "Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik".

Si shembull

OE duhet të posedoj ISO Çertifikatat për pastrim ISO 9001-2015, ISO 14001-2015, ISO 45001-2018.

Kërkesa e tillë nuk është se garantonë ndonjë standartë në fushën e aktivitetit të pastrimit por vetëm ngarkesë shpenzuese për OE pasi që jemi mirë të vetë dijëshem se këto standarte të kërkuara problem të jemi të njohur edhe si shtetë.

Kërkesa tjetër

- **OE duhet te deklarohet se do ti paguan te gjithe punetoret pagat e njejta me**

punetoret e ketij sektori ne bruto prej 320-euro duke i kalkuluar sipas rregullave të ATK-së.

- **OE duhet te kete 1(nje) menaxher. Paga Bruto per (Bruto) per menaxherin 450.00€ plus 5% kontributet e punedheneit, menaxhrei duhet te kete te perfunduar fakultetin Ekonomik ose Juridik ose masterin dhe te kete 3 vite pervoje pune.**

- **OE duhet te kete 1(nje) pergjegjes. Paga Bruto per (Bruto) per pergjegjesin 350.00€ plus 5% kontributet e punedheneit, pergjegjesi duhet te kete te perfunduar shkollen e mesme dhe te kete 2 vite pervoje pune.**

- **OE duhet të deklarohet se do ti kryej të gjitha obligimet financiare për kontributet e punëtorve dhe do ti respektoj të drejtat e tyre sipas ligjit të Punës 03 L-212.**

Ju keni kërkuar që për pozitat e cekura pagat e caktuara ku keni këruar që me një deklaratë të respektohet Ligji Punës por duke qenë në dijeni se Ligji i Punës ka shumë benitite për punëtor kërkojm që të qartësohet se cilat janë benifitet që duhet respektuar si shembull festta,vikendi,pushimi vjetor etj.

Po ashtu kërkes tjetër

OE të jetë i pajisur me dokumentacion sipas kërkesave të Ligjit në fuqi për riskun, për siguri dhe shëndet në punë. OE duhet të dëshmoj raportin e vlerësimit të rriskut për të gjitha pozitat sipas organogramit dhe organizimit të kompanisë nga një kompani e e licencuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Kërkojm se kjo kërkes që për arsye se ka pozita të ndryshme në këtë projekt të bëhet e mundur që të përmes një deklarate zotuese të premtohet që brenda 30 ditë pas nënshkrimit të kontratës të bëhet vlerësimi i rriskut.

Po ashtu lidhur me matreialet e kërkuara dhe sasit ju keni vendosur të jepen dhe qmime por nuk keni lënë të qartë se si do të vlerëohen qmimet e dhëna po ashtu kufizimi i i sasis së litrave si psh 1L,,2L etj mendojm se është i tepërt pasi që OE janë të lirë që të ofrojn qfardo zgjidhje teknike që i përshtatet poltikave të dy palëve.

Kërkojmë nga ana e AK-së që të APROVOJ kërkesën tonë për rishqyrtim dhe të korrigjoj dosjen e tenderit dhe të largon kërkesat e panevojshme nga ky aktivitet i prokurimit të cilat konsiderojmë se janë të tepërta, të panevojshme dhe diskriminuese marr parasysh natyrën dhe qëllimin e kësaj kontrate.
Me datë 04.01.2023 AK ka dërguar një vendim por se nuk ka sqaruar ose nuk ka dhënë sqarimet e kërkuara duke lënë pa qartësi....

Për arsye të afateve kohore ne e dorëzojm ankesen vetem sa për të fituar të drejtën tonë të ankimit brenda afateve ligjore konform LPP-së do e plotësojm atë.....

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Mundësia e reklamimit të kompanis tonë në tregë si kompani serioze dhe mundësia e fitimit të kontratës.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
e) *bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
f) *Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*